



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

Nr. 4170 Prot.

Datë 30 / 06 / 2026

URDHËR

Nr 2, datë 30.06/2026

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË MINISTRIT TË SHTETIT
PËR PUSHTETIN VENDOR DHE INSTITUCIONIT TË VARËSISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Vendimit nr. 859, datë 26.12.2024, i Këshillit të Ministrave, Vendimit nr.520, datë 25.9.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor”, si dhe në përputhje me objektivat e reformës në administratën publike dhe të integritetit institucional.

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Ministër Shteti për Pushtetin Vendor dhe Institucionit të varësisë.
2. Agjencisë së Mbështetjes për Vetëqeverisjen Vendore për periudhën 2026-2027 sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e tij kabineti i Ministrit si dhe të gjithë punonjësit e institucionit të varësisë (AMVV) sipas fushë së tyre të përgjegjësisë.
4. Ngarkohen anëtarët e kabinetit dhe strukturat në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

ERVIN DEMO

PLANI I INTEGRITETIT

MINISTËR I SHTETIT PËR PUSHTETIN
VENDOR

2026-2027

Miraturar me Urdhrin nr.2, date 30.06.2026, të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit për Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor

- | | |
|------------------------|---|
| 1. Silvana Merdani | Drejt看 Kabineti, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor |
| 2. Z. Stiv Mello, | Këshilltar, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor |
| 3. Znj. Olta Caca, | Drejt看, Drejt看 e Statistikës dhe Performancës,
Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| 4. Znj. Jonela Gjinaj, | Drejt看, Drejt看 e Trajnimit Dhe Fuqizimit të Kapaciteteve
Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| 5. Marsela Maçi, | Drejt看, Drejt看 e Integritetit Evropian dhe Projekteve
Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E INTEGRITETIT.....	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
1. PLANI I INTEGRITETIT	6
1.1. Procesi i hartimit të Planit të Integritetit	4
1.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit.....	4
1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut	5
1.1.3 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut	5
2. QASJA METODOLOGJIKE	7
3. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT	7
4. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT TË IDENTIFIKUARA	8
4.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me kuadrin e brendshëm rregullator dhe institucional mbi integritetin dhe etikën.....	9
4.2 Risqe dhe faktorët e risqeve të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimi i tyre në vijimësi për çështje të integritetit	9
4.3 Risqe dhe faktorët e risqeve të lidhura me transparencës dhe komunikimin dhe aktorët e jashtëm mbi veprimtarinë e MSHPV.....	8
5. PLANI I VEPRIMIT DHE MONITORIMI	9

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Lufta kundër korrupsionit është ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor është i angazhuar në vazhdimësinë e përpjekjeve pozitive që qeveria ka ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit për ndërtimin e një administrate publike me integritet dhe pa korrupsion. Krijimi i mekanizmave antikorrupsion të cilat i shërbejnë krijimit të një stafi që funksionon mbi baza integriteti, etike dhe meritokracie në përputhje me stadardet europiane, është në prioritetet kryesore të Ministrit të Shtetit.

Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit për vitet 2026-2027, pasqyron përpjekjen tonë me qëllim rritjen e performancës institucionale nëpërmjet ushtrimit me integritet dhe profesionalizëm të funksioneve dhe detyrave mbi bashkërendimin e punës për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me veprimtarinë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Masat e mara në këtë instrument strategjik normojnë identifikimin dhe parandalimin e risqeve ndaj korrupsionit që çënojnë integritetin e zyrtarëve të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe punonjësve të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore gjatë ushtrimit të detyrave shtetërore, sipas fushës funksionale të përgjegjësisë, si dhe të parashikojnë masa konkrete në adresimin e tyre.

Besojmë se ky instrument strategjik do të mbështesë forcimin e integritetit institucional, si dhe kultivimin e një kulture pune që bazohet në respektin për zbatimin e ligjit dhe etikën profesionale dhe do të konsolidojë vullnetin tonë për integritet institucional në proceset e brendshme vendimmarrëse dhe operacionale, bazuar në parimet e mirëqeverisjes dhe profesionalizmit.

Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Ervin DEMO

LISTA E SHKURTESAVE

MSHPV	Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BNJ	Burime Njerëzore
BE	Bashkimi Evropian
GPI	Grupit të Punës për Integritetin
PT	Programi i Transparencës
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit
PSV	Procedura Standarde Veprimi

1. PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV), u hartua gjatë periudhës Prill-Maj 2026, duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Qeverisjen Qendrore. Qëllimi i hartimit të Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- i. Vlerësimi i risqeve të integritetit, me të cilat mund të përballen zyrtarët e lartë të MSHPV-së, si dhe punonjësit e institucionit të varësisë AMVV-së gjatë ushtrimit të detyrave të tyre me paanshmëri dhe përgjegjshmëri si dhe;
- ii. Parashikimi i masave përkatëse për adresimin e tyre;

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe shkakut të tyre u bazua në proceset e punës bazuar në fushën e përgjegjësisë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe institucionit të varësisë AMVV-së, të cilat përfshijnë:

- i) risqe të lidhura me kuadrin rregullator dhe institucional;
- ii) risqe të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore;
- iii) risqe të lidhura me transparencën dhe komunikimin me aktorët e jashtëm;

1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit dhe miratimit të Planit të Integritetit kaloi në fazat e mëposhtme:

1.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit

Me Urdhër nr 1, date 10.04.2026, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ngriti Grupin e Punës për vlerësimin e riskut të integritetit për hartimin e planit të integritetit të MSHPV dhe institucionit të varësisë AMVV, të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë me qëllim hartimin e Planit të Integritetit dhe masave/ aktiviteteve të përshtatshme kontrolluese për personat me funksione të larta ekekuative të MSHPV dhe punonjësve të AMVV.

1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, grupi i punës e u fokusua në identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit nëpërmjet analizimit të kuadrit ligjor dhe rregullator sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHPV, si dhe në organizimin funksional të veprimtarinë së institucionit të varësisë AMVV.

Në analizë u morën detyrat dhe kompetencat e MSHPV, detyrat e anëtarëve të kabinetit si dhe detyrat e dhe funksionet e AMVV dhe punonjësve të institucionit, duke kryer një vlerësim të fushave të cilat rezultojnë më të ekzpozuar ndaj risqeve të integritetit. Në bazë të rezultateve të kësaj analize risqet e identifikuar u renditën sipas rëndësisë dhe ndikimit të tyre.

1.1.3 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Me qëllim adresimin e risqeve të integritetit të identifikuar, grupi i punës hartoi Planin e Veprimit për menaxhimin e tyre. Plani i veprimit përfshiu masa dhe aktivitete të përshtatshme kontrolluese dhe korrigjuese, të cilat synojnë ushtrimin me integritet të detyrës nga anëtarët e kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe stafit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit për zbatimin është parashikuar, për periudhën 2026-2027.

2. QASJA METODOLOGJIKE

Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit në zbatim të tij është hartuar në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit, miratuar me urdhër të Ministrisë të Drejtësisë nr. 334, datë 07.10.2020 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore” dhe është mbështetur në praktikën më të mirë rreth çështjeve të integritetit në institucionet.

Me urdhrin nr 1, datë 10.04.2026, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ngriti Grupin e Punës për hartimin e planit të integritetit dhe planit të masave të përshtatshme kontrolluese për anëtarët e kabinetit dhe punonjësit e AMVV.

Grupi i punës, kreu disa takime përgjatë periudhës përgatitore me qëllim hartimin e një Plani Integriteti dhe Planit të Veprimit i cili reflekton dhe i përgjigjet situatës dhe nevojave aktuale institucionale, lidhur me integritetin institucional.

Fokusi i Grupit të Punës për Integritetin u mbështet në këto drejtime kryesore:

1. Analizën e kuadrit ligjor dhe institucional të MSHPV dhe institucionit të varësisë AMVV, në aspektin e etikës dhe integritetit;
2. Analizën e proceseve të punës sipas fushave të përgjegjësisë institucionale;
3. Analizës mbi menaxhimin e burimeve njerëzore;
4. Analizës së proceseve të transparencës dhe komunikimit të brendshëm me aktorët e jashtëm dhe publikun.;

Në përfundim të procesit të analizës, rezultatet u integruan në Planin e Integritetit dhe shërbyen si bazë për hartimin e Planit të Veprimit dhe masave /aktiviteteve përkatëse për stafin e kabinetit të MSHPV dhe stafit të AMVV.

Risqet e identifikuar u ndanë në fushat si më poshtë:

1. Në fushën e kuadrit rregullator dhe institucional mbi etikën dhe integritetin.
2. Në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.
3. Në fushën e transparencës dhe komunikimit me publikun dhe aktorët e jashtëm.

Bazuar në informacionin e mbledhur GPI, vijoi me hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Planit të Veprimit 2026-2027 në zbatim të tij, ku u përcaktuan konkretisht masat dhe aktivitetet e nevojshme, si dhe afatet për zbatimin e tyre dhe indikatorët përkatës të cilat pritet të kenë impakt pozitiv, në kuadër të integritetit institucional.

3. PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet si më poshtë:

- **Deklarata e Integritetit Institucional** – shprehja e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor;
- **Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit**, përshkrimi i fazave të procesit të planifikimit të integritetit dhe qasja metodologjike;
- **Risqet e integritetit dhe faktorët e tyre** - përfshin një përshkrim të risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre sipas fushës së përgjegjësisë së MSHPV-së dhe institucionit të varësisë AMVV, lidhur me etikën dhe integritetin institucional;
- **Plani i Veprimit** - përmban masa/aktivitete që duhet të ndërmerren, për të adresuar risqet e identifikuara.

4. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT TË IDENTIFIKUARA

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza e risqeve të integritetit dhe faktorët e tyre, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore të MSHPV dhe veprimtarisë të AMVV si më poshtë vijon:

4.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me kuadrin e brendshëm rregullator dhe institucional mbi etikën dhe integritetin.

Një nga prioritetet i Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor është konsolidimi i vazhdueshëm i vlerave të etikës profesionale të anëtarëve të kabinetit dhe punonjësve të Agjencisë për Mbëhstetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV). Aktualisht funksionarët e kabinetit të MSHPV, zbatojnë Kodin e Etikës së Kryeministrisë, ndërsa punonjësit e AMVV-së gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale zbatojnë rregulloren e brendshme të institucionit. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka hedhur hapat fillestarë drejt ndërtimit të një kuadri të integruar për menaxhimin e integritetit institucional, duke miratuar disa dokumente themelore në këtë drejtim, si Rregulloren e Brendshme sipas organigramës së miratuar si dhe përshkrimet e punës për secilin funksion, si dhe rregulla për parandalimin e konfliktit të interesit, mbrojtjen e të dhënave personale etj, por nga analiza rezulton se ato nuk përfshijnë të gjitha dimensionet e menaxhimit të integritetit si (dhuratat, aktivitetet e jashtme, lobimi, pas-punësimi,) etj. Me qëllim ndërtimin e një kulture të fortë integriteti është i nevojshëm ndërgjegjësimi dhe përmirësimi i njohurive të këshilltarëve të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe stafit të institucionit të varësisë AMVV, për zbatimin në praktikë të kërkesave ligjore në fushën e etikës dhe integritetit.

Në këtë aspekt është konstatuar mungesa e Kodi Etik për rrjedhojë hartimi dhe miratimi i tij është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës, Ky kod duhet të përmbajë rregulla që lidhen me: procesin e deklarimit dhe pranimit të dhuratave, administrimin e regjistrat përkatës, shpenzime të mbuluara nga të tjerët; rregulla për pranimin e donacioneve/ sponsorizimeve dhe funksionimin e regjistrat përkatës; rregulla për veprimtaritë e jashtme si dhe detyrimin e standardet e sjelljes pas mbarimit të detyrës (pas-punësimit). Pas konkludimit të këtij dokumenti duhet të sigurohet shpërndarja e tij tek funksionarët e kabinetit dhe punonjësit e AMVV dhe trajnimi i tyre me qëllim implementimin efektiv të detyrimeve që burojnë prej tij.

4.2 Riske dhe faktorët e risqeve lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore në fushën e integritetit dhe etikës;

Zbatimi efektiv i standardeve të sjelljes etike të zyrtarëve të lartë politik në sektorin publik përbën një parakusht thelbësor për garantimin e shtetit të së drejtës dhe besimit të qytetarëve. Me qëllim për të kontribuar në ndërtimin e një kulture të fortë integriteti është e nevojshëm ndërgjegjësimi dhe përmirësimi i njohurive të këshilltarëve politikë të kabinetit të ministrit të shtetit për pushtetin vendor të cilët do të kryejnë një trajnim fillestar për çështje që lidhen me zbatimin praktik të kërkesave ligjore ekzistuese në fushën e etikës, parandalimit të konfliktit të interesit dhe integritetit. Njëkohësisht do të zhvillohen trajnime periodike në vijimësi edhe për stafin e institucionit të varesisë AMVV në këtë drejtim. Rrisqet në këtë fushë mund të hasen në aspekte dhe etapa të ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, si procedurat e rekrutimeve, zgjedhja, largimi i personelit nga puna, miratimi, zbatimi apo ndryshimi i strukturës organizative. Riorganizimi dhe përshtatja e vazhdueshme organizative janë procese të nevojshme në interes të rritjes së eficiencës së menaxhimit të burimeve njerëzore por gjatë analizës është konstatuar se në rregulloren e brendshme të institucionit mungojnë rregullat për vlerësimin e performancës së punonjësve të cilat duhet të inkorporohen në rregullore, si dhe Hartimi i Procedurave Standarde të Veprimit të cilat rregullojnë në detaje proceset e punës të cilat vlerësohet që do të kontribuojë në përcaktimin e hapave, detyrave dhe përgjegjësi të qarta për secilën strukturë dhe punonjës të institucionit, duke ndikuar dhe ulur kështu veprimin e faktorëve të riskut të integritetit. Në strukturat e AMVV-së u konstatua se ekziston një vetëdije e përgjithshme mbi rëndësinë e respektimit të standardeve të integritetit, por nevojitet më tej forcimi i mekanizmave mbështetës përmes trajnimeve dhe informimit të rregullt (ndërgjegjësimi) fillestar dhe të vazhdueshëm për integritetin, etikën dhe parandalimin e korrupsionit.

4.3 Riske dhe faktorët e risqeve të lidhur me transparencën, komunikimin dhe aktorët e jashtëm mbi veprimtarinë e MSHPV dhe AMVV.

Parimi i transparencës si një parim bazë në veprimtarinë e administratës publike për publikimin e informacionit në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjëresishëm i kuptueshëm nga publiku individë dhe grupe të caktuara të shoqërisë, si dhe komunikim me aktorët e jashtëm mbi veprimtarinë e MSHPV dhe AMVV është një tjetër element i rëndësishëm që paraqet një nivel risku, ku marja e masave do të konsolidojë integritetin institucional. Me shumë rëndësi në këtë drejtim vlerësohet pasurimi i faqeve zyrtare të internetit të MSHPV dhe AMVV, të cilat duhet të përmbajnë të gjithë elementët që garantojnë një transparencë proaktive me publikime të rregullta dhe të përditësura bazuar në fushën e përgjegjësisë.

5. PLANI I VEPRIMIT DHE MONITORIMI

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për trajtimin dhe adresimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre të identifikuar sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të MSHPV dhe institucionit të varësisë AMVV dhe proceseve të punës më të ekspozuara ndaj riskut të integritetit. Ky dokument përbën një mekanizëm rregullator për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plani i Veprimit ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

- Objektivi 1. Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- Objektivi 2. Përmirësimi i sistemit të menazhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve që lidhen me aspekte të etikës dhe integritetit;
- Objektivi 3. Rritja e transparencës dhe komunikimit me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm lidhur me veprimtarinë e MSHPV dhe AMVV;

6. MONITORIMI

Procesi i zbatimit dhe monitorimit synon të sigurojë që progresi ndaj objektivave të Planit të Integritetit të matet në mënyrë të rregullt, transparente dhe të krahasueshme në kohë. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës i caktuar nga titullari i institucioni i cili ndjek progresin e zbatimit. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit i masave/aktiviteteve të parashikuara kryhet sistematikisht me periodicitet 6 mujor dhe vjetor dhe përfshin verifikimin e zbatimit të detyrave të ngarkuara brenda afateve të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të miratuara në planin e veprimit. Pjesë e këtij procesi do të jetë vlerësimi i efektivitetit të masave të zbatuara, impakti pozitiv që kanë sjellë ato në uljen e risqeve të integritetit dhe eliminimin e faktorëve të tyre, me qëllim vlerësimin e rishikimit të tyre dhe parashikimin e masave të reja në të ardhmen.

Raporti i Monitorimit do të përgatitet çdo 6 muaj dhe do të përcaktohen personat përgjegjës për koordinimin e këtij procesi.

Aneks: Plani i Veprimit për zbatimin e Planit të Integritetit (tabela)

Objektivi 1: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit							
Nr.	Fusha me risk/ Faktorët e riskut	Masa për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e integritetit.	Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Strukturat përgjegjëse	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Afati i zbatimit të aktivitetit.	Indikatori i masës
1	Risqe dhe faktorët me risk që lidhen me kuadrin e brendshëm rregullator dhe institucional mbi etikën dhe integritetin	1.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional mbi etikën dhe integritetin	I Lartë	MSPV AMVV	1.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Kodit Etikës. 1.1.2. Analiza dhe përcaktimi i standardeve. 1.1.3. Miratimi dhe publikimi i Kodit Etik ku të përcaktohen: -rregulla për pranimin e dhuratave; -pranimin e donacioneve; -për veprimtaritë e jashtme -për standartet e sjelljes pas punësimit; -rregulla për	2026-2027	Kodi Etik i miratuar dhe i publikuar dhe i shpërndarë për njohje.

				deklarimin e tyre me lobistë; 1.1.4. Miratimi dhe Publikimi i Kodit Etik 1.1.5 Trajnimi i anëtarëve të kabinetit të MSHPV dhe stafit të AMVV lidhur me përmbajtjen e Kodit Etik.			
			Mesatar	MSHPV AMVV	1.2.1 Shpërndarja me qëllim informimi e paketës së akteve (Format on line vjetore). 1.2.2Trajtime për (këshilltarët) dhe stafin e punonjësve të AMVV	2026-2027	Funksionarë politikë dhe stafi i AMVV të informuar me përditësimine paketës së akteve ligjore mbi integritetin dhe antikorrupsionin.
				1.12.Hartimi i paketës së akteve ligjore mbi integritetin dhe antikorrupsionin, për informimin e Këshilltarëve të kabinetit dhe punonjësve të AMVV.			

Objekti 2: Përmirësimi i sistemit të menazhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve që lidhen me aspekte të etikës dhe integritetit;							
Nr	Fusha me risk/ Faktorët e riskut	Masa për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e integritetit.	Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Strukturat përgjegjëse	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Afati i zbatimit të aktivitetit.	Indikatori i masës
1	Risqe dhe faktorët me risk që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kualifikimin e tyre lidhur me aspekte të etikës dhe integritetit.	1.1 Trajnimi i anëtarëve të kabinetit mbi detyrimet ligjore që lidhen me integritetin dhe etikën. 1.2 Hartimi i planit vjetor të trajnimeve mbi integritetin dhe etikën, për stafin e AMVV.	I Lartë	MSHPV AMVV	1.1.1 Trajnimi i anëtarëve të kabinetit të sapoemëruar. 1.2.1 Evidentimi i nevojave të stafit të AMVV për trajnim 1.2.2. Zbatimi i planit vjetor të trajnimeve.	2026-2027	Funksionarë të lartë të mirë informuar ne lidhje me çështjet e etikës dhe integritetit.
2	Procedura standarde të veprimit për çdo pozicion pune në mungesë.	2.1. Hartimi i PSV, për të gjitha pozicionet e punës në AMVV.	Mesatar	AMVV	2.1.1. Hartimi dhe miratimi i PSV-ve për çdo proces pune 2.1.2 Trajnimi i punonjësve për PSV-të e miratuara	2026-2027	Dokumente të miratuara lidhur me proceset e punës, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave.

3	Mungesa e procedurave të vlerësimit të performancës së punonjësve në rregulloren e brendshme	3.1Përfshirja në rregulloren e brendshme të institucionit e procedurave të vlerësimit të performancës.	Mesatar	AMVV	3.1.1 Hartimi dhe miratimi i formularëve për vlerësimin e performancës. 3.1.2. Njohja e punonjësve më formularët e vlerësimit të performancës në punë.	2026-2027	Vlerësim i punonjësve bazuar në performancë.
---	--	--	---------	------	---	-----------	--

Objekti 3. Rritja e transparencës dhe komunikimit me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm lidhur me veprimtarinë e MSHPV dhe AMVV;							
Nr	Fusha me risk/ Faktorët e riskut	Masa për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e integritetit.	Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Strukturat përgjegjëse	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës.	Afati i zbatimit të aktivitetit.	Indikatori i masës
1	Risqet dhe faktorët me risk që lidhen me rritjen e transparencës dhe komunikimin me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm.	1.1.Publikimi i informacionit të plotë në faqen zyrtare mbi veprimtarinë e MSHPV dhe AMVV.	Mesatar	MSHPV AMVV	1.1.1. Krijimi, plotësimi dhe përditësimi i faqes zyrtare të MSHPV dhe institucionit të AMVV 1.1.2. Publikimi i informacionit të zgjeruar mbi anëtarët e kabinetit dhe veprimtarisë së tyre në faqen e MSHPV. 1.1.3. Publikimi i të dhënave referuar në ligjin për të drejtën e informimit publik	2026-2027	Faqja zyrtare e MSHPV dhe AMVV e përditësuar me informacion të plotë.

2	Përmirësimi i programit të transparencës.	2.1. Transparencë proactive bazuar në ligjin për informimin dhe konsultimin publik në lidhje me publikimin e informacionit.	Mesatar	MHPV AMVV	2.1.1. Publikimi plotësimi dhe përditësimi me informacion proaktiv të programit të transparencës. 2.1.2. Plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm i përditësuar sipas akteve ligjore për një transparencë proactive me publikun.	2026-2027	Program transparencë i plotë i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare.
---	---	---	---------	--------------	---	-----------	--